



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 114, Datë 21.04.2026

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 46, DATË 17.02.2026  
“MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SH.A.  
NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/5 prot., datë 17.04.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 46, datë 17.02.2026 “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

**1. Të dhëna mbi shoqërinë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a.**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 46, datë 17.02.2026, vendosi të rinovojë licencën nr. 343, Seria F16/F21, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 81, datë 09.06.2016, dhe rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 134, datë 07.06.2021, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 11.06.2026.
- Në pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar se: *brenda datës 31.03.2026, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës, ndërsa në pikën 3 i është lënë detyrë shoqërisë që të depozitojë vendimin e gjykatës në lidhje me detyrimet tatimore menjëherë sapo ta disponojë atë.*

**2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria**

- Me shkresën nr. 20/3 prot., datë 19.02.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin nr. 46/2026, duke i sjellë në vëmendje detyrimin për depozitimin e kontratës së rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit, si dhe depozitimin e vendimit të gjykatës në lidhje me detyrimet tatimore, menjëherë sapo ta disponojë atë.
- Me shkresën e saj të datës 31.03.2026, protokolluar në ERE me nr. 134/4 prot., datë 01.04.2026, shoqëria ka depozituar Kontratën e Qirasë të rinovuar për disponimin e zyrave, ku përcaktohet se periudha e vlefshmërisë është nga data 01.04.2026 deri më 31.03.2027.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit shoqëria ka bërë me dije se nuk ka ende një vendim të gjykatës dhe ka shprehur gatishmërinë e saj për të depozituar në ERE vendimin e formës së prerë menjëherë pas disponimit të tij. Si e tillë, kjo pikë mbetet e pandryshuar.

### **3. Analiza ligjore dhe vlerësimi**

- Afati i përcaktuar në kontratën e rinovuar nuk mbulon të gjithë afatin e vlefshmërisë së licencës, ndaj lind nevoja për t'u ndryshuar pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 46/2026, ku të përcaktohet se: *shoqëria duhet të depozitojë brenda datës 31.03.2027, kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.*

### **4. Nevoja për ndryshimin e vendimit**

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, lind nevoja për të ndryshuar pikën 2 të vendimit nr. 46/2026 me përmbajtje si vijon: “2. *Brenda datës 31.03.2027, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.*”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e bordit të ERE-s nr. 46, datë 17.02.2026, si vijon:
  - a) Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 46, datë 17.02.2026, ndryshon dhe bëhet: 2. *Brenda datës 31.03.2027, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. dhe “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijoni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**